



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë , më ___/___/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: “ Inform Albania“ sh.p.k

Adresa : Rruga “Çerçiz Topulli“ Nr.17 Kashar,Tiranë

Procedura e prokurimit: “Shërbim printim fatura uji ” me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-58804-05-22-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbim printim fatura uji” me fond limit **4.773.809,3** (katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntë presje tre)lekë pa TVSH.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):

Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. ”**Inform Albania**” sh.p.k

L11518003F

Vlera **3,923,420** (tre milionë e nëntëqind e njëzetë e tre mijë e katërqind e njëzetë) lekë pa tvsh.

2. “**Kristalina K.H**” sh.p.k

K11501002D

Vlera **4,605,932** (katër milionë e gjashtëqind e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh.

3. “**Media- Print**” sh.p.k

K61313010H

Vlera **4,771,400** (katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

3. “**Media- Print**” sh.p.k

K61313010H

Vlera **4,771,400** (katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë pa TVSH.

Përkatësisht për arsyen e mëposhtne:

3.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Media- Print” sh.p.k me vlerë 4,771,400 (katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës (nëse është kërkuar) sipas Shtojcës 3.

b. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6.

c Deklaraten mbi permbushjen e specifikimeve teknike sipas Shtojcës 5.

ç Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojca 8/1;

d.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

“Në përmbushje të kriterit të kërkuar operatori ekonomik “**Media-Print**” sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik :

“Vërtetim debie” nr: 2135 prot, date 12/03/2018 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike vertetojm se kërkuesi “Media-Print” sh.p.k nga verifikimet e kryera në sistemin e Faturimit, për kontratën/ kontratat bashkëlidhur, titullari I të cilave është Media-Print SHPK rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 12.03.2018, pa përfshirë faturën koherente të muajit Shkurt 2018.

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Mars 2020.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “nuk

plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “d” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se *”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”*

Në shtojcën 7 shprehimisht parashikohet se**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Pra, sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Inform Albania sh.p.k se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme **3,923,420** (tre milionë e nëntëqind e njëzetë e tre mijë e katërqind e njëzetë) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a ,Drejtoria e Prokurimeve, Adresa: Rruga E Kavajës Ndërtesa Nr,133, Njësia Administrative Nr 6,Kodi Postar 1027 Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.05.2020

Ankesa: **JO**